



LAJME nga FONDACIONI
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË
Tiranë

N.23
Dhjetor
2025

Redaksia "ZKM ALBANIA"
Kompleksi Spitalor Universitar
"Zoja e Këshillit të Mirë"
Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë

unikzkm
unikzkm
www.unizkm.al
pr@fzkm.org



nga Fr. Ruggero Valentini

President
i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë
Tiranë



RINISJA NGA BESIMI

Shqipëria e fundit

Besimi social ose aftësia për t'i besuar "shumicës së njerëzve" konsiderohet një nga elementët kyç që mban të lidhura komunitetet, forcon institucionet dhe nxit zhvillimin ekonomik.

Të dhënat e fundit nga Integrated Values Surveys të publikuara në vitin 2024 dhe të mbledhura gjatë vitit 2022 rendisin 90 ekonomi globale bazuar në nivelin e besimit që qytetarët shprehin tek njëri-tjetri. Vendet nordike kryesojnë bindshëm renditjen. Në vend të parë renditet Danimarka me 74% të të rriturve që deklarojnë se " shumica e njerëzve janë të besueshëm", e ndjekur nga Norvegjia (72%) dhe Finlanda (68%). Suedia dhe

Islanda plotësojnë pesë vendet e para me nivelin më të lartë të besimit. Kina është i vetmi vend jo perëndimor në dhjetë vendet e para duke u renditur me 63%. Në anën tjetër të renditjes situata është shumë më pak optimiste veçanërisht për Shqipërinë.

Ajo renditet e fundit nga 90 vende ku vetëm 3% e njerëzve i beson të tjerëve. Kjo tregon se shqiptarët kanë një nga nivelet më të ulëta të besimit social në botë.

Ekspertët lidhin këtë rezultat me faktorë të tillë si dobësia historike e institucioneve publike, polarizimi politik, përhapja e informalitetit dhe pasiguria ekonomike, elementë që e bëjnë të vështirë ndërtimin e kapitalit social.

Në një klimë kaq të ulët besimi, bashkëpunimi ndërmjet individëve, funksionimi i institucioneve dhe vullneti për angazhim qytetar priren të jenë

shumë më të dobët. Ndërsa vendet nordike shfrytëzojnë nivele të larta besimi për të mbështetur ekonominë dhe politikat e tyre sociale, sfida e Shqipërisë mbetet rindërtimi i këtij kapitali social thelbësor, një proces i ngadaltë por i domosdoshëm për zhvillim të qëndrueshëm.



Krishtlindje në Kampus

Hapësirë për urimet e Krishtlindjes



Magjia e Krishtlindjes përfshiu studentët në kampusin tonë universitar që me vitalitetin dhe mendjet plot ëndrra u bashkuan për të dekoruar ambientet e universitetit.

Nga hyrja e godinës qendrore në UKZKM, tek biblioteka deri tek një nga hollet kryesore, të rinjtë bashkuan gëzimin dhe harenë që sjellin festat e fundvitit. Ju urojmë gëzuar studentë të dashur!

Një vit të mbarë 2026 sepse suksesi juaj është shpërblimi më i mirë për Universitetin Katolik Zoja e Këshillit të Mirë”.

NJË PIKË REFERIMI E RËNDËSISHME NË SHQIPËRI

Spitali Katolik

Viti 2025 ishte një tjetër vit pune të palodhur për ekipin e madh të Spitalit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë në Tiranë.

Me vizion të qartë në shërbim ndaj jetës dhe shëndetit të individëve dhe të familjeve pa asnjë lloj dallimi dhe në përmbushje të misionit të krishterë dhe Doktrinës Sociale Katolike. Duke ndërtuar



reputacion të besueshëm çdo ditë, kjo qendër moderne shëndetësore ofron trajtim modern jo vetëm në sistemin e përparuar të aparaturave, por edhe në nivelin e lartë profesional të mjekëve e infermierëve.

Vizitoni faqen zyrtare të Spitalit Katolik (🌐 www.zoja.al) për të mësuar më shumë rreth shërbimeve tona.

Nuk ka rëndësi nëse je shqiptar apo i huaj, në këtë qendër shëndetësore do të marrësh shërbim të kualifikuar.

HISTORIA PROFESIONALE DHE ANGAZHIMI PËR KOMUNITETIN



P prej 17 vjetësh Klinika Stomatologjike Universitare “Zoja e Këshillit të Mirë” është një vend ku aftësia, kujdesi dhe ndjeshmëria njerëzore takohen çdo ditë. Angazhimi ynë është i thjeshtë, por thelbësor: **të kujdesemi për buzëqeshjen dhe shëndetin oral të pacientëve tanë** duke ofruar një mjedis të sigurtë, mikpritës dhe me respekt të thellë.

Në të njëjtën kohë ne kujdesemi për të siguruar shërbime të sigurt dhe në përputhje të plotë me atë që në mjekësi përcaktohet si “evidence-based” që do të thotë bazuar në provat më të mira shkencore të disponueshme. Por roli ynë nuk kufizohet vetëm në kujdesin klinik.



Qendra është një pikë referimi për formimin praktik të studentëve të programit të Odontoiatrisë dhe Protezës Dentare pranë Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin Katolik. Shumë nga profesionistët që sot punojnë me ne kanë filluar rrugëtimin e tyre pikërisht si studentë të universitetit tonë gjë e cila është dëshmi e qartë e angazhimit tonë në formimin e brezave të rinj. Ne organizojmë programe dhe formime pasuniversitare si për studentët tanë, ashtu edhe për të diplomuarit nga

universitete të tjera, kombëtare dhe ndërkombëtare duke krijuar një hapësirë ku profesionistët mund të rriten, të bashkëpunojnë dhe të përmirësohen. Ne gjithashtu kemi një lidhje të veçantë me komunitetin. Prej vitesh organizojmë fushata ndërgjegjësimi për shëndetin oral në shkolla dhe kopshte me qëllim edukimin dhe mbrojtjen e fëmijëve që në vitet e para të jetës. Falë projekteve të mbështetura nga Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ne ofrojmë gjithashtu shërbime stomatologjike falas për kategoritë më vulnerabel – një angazhim solidariteti që e konsiderojmë pjesë thelbësore të misionit tonë.

Pas 17 vitesh punë, përkushtim dhe pasion klinika jonë është bërë një pikë referimi e rëndësishme në Shqipëri si për cilësinë e trajtimeve që u ofrojmë pacientëve tanë ashtu edhe për rolin themelor që luajmë brenda kampusit universitar në formimin e profesionistëve të rinj në fushën e stomatologjisë.

NJË "STOL I KUQ" NË UKZKM

Jo dhunës, mos hesht, reago!

Me pankarta në duar, me hapa të vegjël dhe në heshtje solemne nderuam në një refleksim të dedikuar vajzat dhe gratë që kanë humbur jetën si pasojë e dhunës. Kampusi Universitar Spitalor "Zoja e Këshillit të Mirë" është jo vetëm hapësira e edukimit dhe profesionalizimit, por edhe hapësira e ndjeshmërisë qytetare dhe të angazhuar duke përcjellë mesazhe bashkimi dhe shprese.

Studentë, profesorë, mjekë, drejtues të Spitalit Katolik dhe UKZKM përshkuan rruginat e kampusit në shenjë nderimi dhe kujtese duke ecur krah njëri-tjetrit me qëllim sensibilizimin e shoqërisë shqiptare kundër dhunës që tragjikisht ka marrë jetë të pafajshme.



Të shoqëruar nga lutjet e Padre Paschal të Baritores së universitetit vajzat dhe djemtë e pranishëm lexuan emrat e viktimave që kanë humbur jetën, lexuan poezi të shkurtra dhe në fund inauguruan sëbashku Stolin e Kuq që do të jetë në kampus si simbol i qytetarëve që nuk heshtin, por e dënojnë dhunën në çdo formë të saj.



Emrat e viktimave të shkruara në letërza u ngjitën mbi dërrasat e Stolit të Kuq, pranë të cilit u vendosën edhe këpucët si simbol i 25 nëntorit ditës ndërkombëtare të Luftës kundër dhunës ndaj grave.

Jemi bashkë për të kujtuar, dhuna nuk luftohet me heshtje!



MIKROKREDITI: PËR NJË EKONOMI NJERËZORE

Moduli
Jean Monnet

Konferenca ndërkombëtare me titull "Mikrokrediti: Një Instrument i Kohezionit Social" u mbajt në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në Tiranë dhe financohet nga programi evropian Erasmus+ si pjesë e Moduleve Jean Monnet. Kjo temë shumë aktuale dhe e thellë fton publikun të reflektojë mbi vlerën sociale të financës, rolin e mikrokreditit si një mjet për përfshirje dhe mundësinë e kombinimit të zhvillimit ekonomik dhe solidaritetit.

Mikrokrediti nuk është vetëm një mundësi ekonomike, por një zgjedhje etike dhe sociale, e aftë të ndërtojë kohezion, dinjitet dhe besim, tha në nisje të konferencës Prof. Asoc Emiljan Karma, PhD, nga Qendra për Kërkime mbi Ekonominë e Vendeve në Tranzicion.

Konferenca u mikprit dhe përshëndet nga Zëvendës Rektori i UKZKM Prof. Edmond Hajdëri dhe Zëvendësdekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale pranë UKZKM Klodian Muço. Moderator i eventit Emiljan Karma theksoi se ky takim përfaqëson jo vetëm një moment akademik, por edhe një gjest komuniteti, në të cilin ndërthuren përvojat, vlerat dhe perspektivat e zhvillimit integral njerëzor. Të ftuar në këtë konferencë ishin **Vitorocco Peragine**, Deputy Rector, University of Bari Aldo Moro (Italy), **Alessandro Azzi**, President, Fondazione Tertio Millennio ETS (Italy), **Arlinda Muja**, President AMA – Albanian Microfinance Association (Albania), **Augusto Dell’Erba**, President, Federcasse – Italian Federation of Cooperative Credit Banks and Rural Banks (Italy), **Flutura Xhabija**, President, SHGPAZ – Association of Professional, Business and Craftsmen in Handicraft (Albania)

KRAHASIMI I BANKAVE ETIKE

Të njëjtën ditë, në Bruksel, u prezantua edicioni i tetë i Raportit mbi Financën Etike në Evropë. Qëllimi i Raportit është të tregojë se si funksionon sot financa etike në Kontinentin tonë: cilat rezultate prodhon, cilat sektorë mbështet, çfarë ndikimi ka mbi komunitetet dhe cilat mjete nevojiten për të bërë kreditimin më të aksesueshëm për realitetet e ekonomisë sociale.

Raporti përqendrohet në tre elemente kryesore:

1. rritja e sektorit, i cili sot menaxhon volume në rritje dhe i orienton kryesisht drejt kreditit;
2. cilësia e kreditit, e cila mbetet e lartë dhe konfirmon një model të bazuar në marrëdhënie dhe në përdorimin e kujdesshëm të burimeve;
3. roli i financës etike në ekonominë sociale, një univers prej miliona organizatash që krijojnë punë, shërbime dhe kohezion në territore.

Raporti thekson: rritjen e sektorit, stabilitetin e kredive, mbështetjen ndaj ekonomisë sociale, ndikimin social dhe mjedisor të financimeve, kushtet e nevojshme për konsolidimin e zhvillimit të tij, si dhe një paralajmërim të rëndësishëm mbi rrezikun e konsiderimit si "të qëndrueshme" të aktiviteteve të lidhura me armët, një praktikë që është në kundërshtim me parimet evropiane dhe me vlerat e financës etike.

Raporti "Capitale Comune" është i disponueshëm në www.fianzaetica.info



PSE DUHET TË LEXOJMË RAPORTIN E FUNDIT

Qendra Europiane e Shkencës për Paqen, Integrimin dhe Bashkëpunimin



Raporti i fundit **"Albania in the Eyes of the World 2024/2025"** nga CESPIC ofron një vlerësim të dyanshëm për trajektoren e Shqipërisë gjatë të cilës vendi ka ruajtur stabilitetin e brendshëm dhe ka shënuar progres në zhvillimin njerëzor.

Megjithatë pengesa serioze mbeten në transparencën qeverisëse, në sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit. Shqipëria e ka forcuar pozicionin në rajon duke u renditur e treta në Indeksin Global të Paqes për 2024 duke dëshmuar stabilitet social.

Në aspektin shoqëror Shqipëria konfirmohet si vend me përmirësime në arsim e shëndetësi dhe ekonomikisht; reformat e tregut dhe integrimi global kanë sjellë performancë pozitive. Por në anën tjetër rritja ekonomike ndikohet nga varësia e tepërt nga turizmi dhe ndërtimi

ndërsa pasiguria e mbrojtjes rregullatore dhe të drejtat e dobëta të pronës kufizojnë zhvillimin afatgjatë. Raporti e vendos Shqipërinë në klasifikimin "Pjesërisht e Lirë" sipas Freedom House gjë që tregon se **sfida kryesore mbetet polarizimi politik**, brishtësia institucionale dhe përgjegjshmëria e kufizuar.

Ndonëse institucione si SPAK kanë prodhuar rezultate, mungesat në vendosmërinë e shtetit ligjor dhe besimin e publikut, pengojnë konsolidimin e plotë të reformave antikorrupsion. Liria e shtypit mbetet nën presion nga interesat politike dhe ekonomike.

Përfundimisht raporti thekson se suksesi i qëndrueshëm varet nga konsolidimi i reformave të qeverisjes diversifikimi ekonomik dhe sigurimi që stabiliteti të përkthehet në zhvillim për të gjithë.

HAPËSIRË E VOGËL
PROMOVUESE



Një hap larg shëndetit tënd!

Kartë Shëndeti për Studentët e Universitetit Katolik
"Zoja e Këshillit të Mirë" me **ULJE TË DEDIKUARA**
në shërbimet mjekesore të **Spitalit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë**.



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË



Spitali Katolik
Zoja e Këshillit të Mirë
Përkushtuar Shëndetit Tënd



NJË TREGUES I RRITJES SOCIALE

Vlera e vullnetarizmit në zemër të Kampusit të ZKM

5 dhjetori njihet si Dita ndërkombëtare e Vullnetarizmit dhe Kampusi ynë ZKM është model i mirë i të rinjve që janë të gatshëm të kontribuojnë në përmirësimin e jetës shoqërore mes studentëve dhe **cilësinë e bashkëveprimit mes të rinjve**. Nga angazhimi në ngjarje kulturore dhe edukative deri tek pjesëmarrja vullnetare në procesin e zgjedhjes së Të Drejtës të vitit, 5 dhjetori na fton të reflektojmë se duke përdorur aftësitë tona jemi të dobishëm për shoqërinë dhe përparojmë komunitetet ku jetojmë. Po kështu të rinjtë tanë shkëlqejnë në eventet sportive dhe muzikore të kampusit, ata janë të duartrokitur me meritë nga bashkëmoshatarët e tyre që gjallërojnë jetën në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”.

Sot inkurajojmë ata që janë në mëdyshje nëse duhet të përfshihen apo jo në **veprimin vullnetar** duke u kujtuar thënien e Nënë Terezës se mund të bëjmë gjëra të vogla me dashuri të madhe dhe kohët sfiduese që jetojmë kanë nevojë për përfshirje dhe akte vullnetare në dobi të më të pamundurave.



NJË BOTË PËR T'U NDRYSHUAR

Dita Botërore e Tokës



Më 5 dhjetor shënohet gjithashtu **Dita Botërore e Tokës**, e caktuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2013. Toka është një burim i kufizuar dhe i pakthyesëm dhe është i nevojshëm për ekzistencën tonë, duke na siguruar ushqim, ujë të pastër dhe duke përfaqësuar një nga rregullatorët kryesorë të klimës së Tokës. Tokat po degradohen gjithnjë e më shumë dhe, kur kjo ndodh, ne rrezikojmë seriozisht aftësinë tonë për të prodhuar ushqim dhe për të ruajtur ekosistemet funksionale. Për vitin 2025, Dita u përqendrua në temën “Tokë e shëndetshme për qytete të shëndetshme”. Kjo temë thekson rëndësinë e kundërshtimit të papërshtueshmërisë dhe humbjes së pjellorisë që rrjedh nga zgjerimi i zonave urbane. Fondacioni ZKM ka nisur prej kohësh një reflektim të vetin, duke planifikuar të ndryshojë qasjen e ndjekur zakonisht në menaxhimin e tokës, e cila favorizon shfrytëzimin e saj para së gjithash në favor të ndërtimit. Kjo logjikë është qartësisht e dukshme për të gjithë në shtrirjen urbane të qytetit të Tiranës (dhe jo vetëm, sepse kjo “sëmundje” prek shumë vende të botës).

Fondacioni ka në plan përgatitjen e një projekti që vendos në radhë të parë mbrojtjen e “hapësirave të gjelbra”, të cilat tashmë janë bërë një nevojë jetike, siç demonstron nga vlerësimi i madh i qytetarëve për kujdesin e treguar ndaj hapësirave të gjelbra të Kampusit tonë.



SI NISI NJË HISTORI SUKSESI NGA PASIONI

Kori "Voice of Zoja"

Siç thoshte këngëtari John Lennon nëse të gjithë kemi të njëjtën ëndërr atëherë ajo do të bëhet realitet.

Ky është rasti i korit të rinjve tanë që na bëjnë krenarë në çdo ngjarje kulturore dhe që emocionojnë me zërat e tyre melodiozë edhe meshat e shenjta.

Kori nisi si një pasion rinor, fillimisht me dy dhe tre veta dhe sot është rritur.

Në rradhët e tij ka talente që spikasin dhe gati-gati e kanë kthyer në angazhim kryesor muzikën pasi mbyllin detyrat universitare.



Aurelio Vneshta merret me organizimin dhe zakonisht çdo të martë apo të mërkurë të rinjtë mbledhen. Aurelio këndon si solist, organizon korin kishtar dhe përgatitjet për evente të posaçme në Kampusin ZKM. Ai i bie organos dhe kitarës. **"Kori i Zojës" ka kapacitetin e mirëfilltë të luajë jo vetëm muzikë kishtarë, por dhe repertor të këngëve patriotike, baladave ose rrymave të tjera që iu përshtaten.**



Për buletin tonë Aurelio tregon se grupi muzikor ka fituar simpatinë nga shumë dëgjues. "Të gjithë jemi miq e dashamirës të njëri-tjetrit, tregon ai, - dhe persa i përket përvojës që po jetojmë, është si një klub universitar në të cilin ne ushtrojmë bashkarisht pasionin tonë për të arritur diçka më shumë sesa puna vetjake".

U urojmë suksese dhe faleminderit për muzikën e bukur Aurelios, Klejvert Kola, Paola Dedaj, Vivian Biagioni, Megi Toma, Maria Cristina, Mariolina, Francesca Rizzo, Melisa Ceka, Siona, Grejs, Jueda Bitri, Obed Govon, Ndoj Shkambi, Ardjan, Francesco Lazzoni, Anisa Nerguti, Denada Garuja, Kejda Çela, Alisa Çela, Kela Dedaj, Adela Mekeshdedaj, Flogerta Dodaj, Hannah Bojaj, Franceska, Vanessa, Benarda, Alessia Buonomo dhe Alisia.



NDËRHYRJE TERAPEUTIKE KOMPLEKSE

Kujdesi për fëmijët me paralizë cerebrale

Në kuadër të projektit "Terapia farmakologjike, trajtimi fizioterapeutik dhe përfitimet e rehabilitimit me hidroterapi tek fëmijët me paralizë cerebrale infantile", i financuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe i realizuar si pjesë e bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës në fushën e arsimit dhe shkencës, stafi i Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" zhvilloi një vizitë në Universitetin "Fehmi Agani" të Gjakovës në nëntor 2025. Delegacioni i përbërë nga Prof. Asoc. Malvina Hoxha, PhD Enkeleda Gjini dhe PhD Emanuela Prendi u prit nga Zëvendës Rektorja e Universitetit të Gjakovës, Dafine Kamberi, Dekani i Fakultetit të Mjekësisë, Prof. Dr. Haxhi Kamberi, si dhe Prof. As. Arben Boshnjaku. Gjatë takimit ekipi i projektit prezantoi dhe diskutoi rezultatet aktuale

të studimeve të kryera duke evidentuar të dhënat paraprake, ndikimin e ndërhyrjeve fizioterapeutike, si dhe të dhënat e reja që po dalin nga vlerësimet e trajtimeve farmakologjike. U përcaktuan gjithashtu hapat e mëtejshëm drejt diseminimit të rezultateve të kërkimit në të dy vendet. Koordinatorët e projektit Prof. Asoc. Malvina Hoxha (Shqipëri) dhe Prof. As. Arben Boshnjaku nga Kosova planifikuan aktivitetet e ardhshme dhe nismat bashkëpunuese në kuadër të projektit.



Në kuadër të aktiviteteve të projektit “Terapia farmakologjike, trajtimi fizioterapeutik dhe benefitet e rehabilitimit me hidroterapi tek fëmijët me paralizë cerebrale infantile”, financuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe zhvilluar si pjesë e bashkëpunimit dy-palësh ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës në fushën e arsimit dhe shkencës, më 21 nëntor 2025 në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” u organizua leksioni i hapur me titull



“Elementët e Neuromodulimit në Paralizën Cerebrale Infantile: Horizonte të reja” i mbajtur nga Prof. Stefano Mugnaini. Leksioni trajtoi në mënyrë të thelluar bazat neurofizilogjike të neuromodulimit, duke përfshirë modifikimet e eksitabilitetit kortikal, neuroplasticitetin e induktuar nga aktiviteti sinaptik, mekanizmat e hebbian dhe anti-hebbian të forcimit dhe zbehjes sinaptike, modalitetet bashkëkohore të neuromodulimit jo-invaziv, si stimulimi magnetik transkranial (TMS), stimulimi transkranial me rrymë të drejtpërdrejtë (tDCS) dhe protokollet e avancuara të stimulimit anodik/katodik për modulimin selektiv të korteksit motor primar.

Ky aktivitet kontribuoi në forcimin e praktikave bashkëkohore në menaxhimin multidisiplinar të paralizës cerebrale infantile.

DHJETRA TË FTUAR NGA E GJITHË BOTA

Një vit plot angazhime



Viti 2025 ishte një tjetër vit suksesi për Universitetin Katolik duke u dhënë hapësirë ngjarjeve akademike, konferencave ndërkombëtare, komunikimit social mes brezave dhe përqafimit të të rejave të zhvillimit teknologjik. Dhjetra të ftuar, profesorë të njohur nga shumë vende të BE-së e jo vetëm ndanë me trupën tone akademike gjatë një viti kalendarik pikëpamje, njohuri, studime dhe të dhëna që përparojnë shkencën, botën mësimore dhe kontribuojnë për zhvillim të qëndrueshëm në Shqipëri.

Aula Magna ishte edhe këtë vit tempulli i takimeve kombëtare dhe ndërkombëtare duke pasuruar njohuritë e studentëve që zgjedhën me mençuri UKZKM për formimin e tyre profesional. Një vit i ri po troket dhe kalendari i ngjarjeve shkencore është edhe më i pasur. Na ndiqni në faqen tonë zyrtare.



KOPSHET SHKOLLA E DEMOKRACISË

Gariwo Network 2025

Gariwo
Network



Nga data 27 deri më 29 nëntor qyteti i Milanos priti një takim të rëndësishëm ndërkombëtar të promovuar nga rrjeti Gariwo, i cili lidh shumë “Kopshte të të Drejtëve” në vende të ndryshme të botës (**Gardens of the Righteous Worldwide**). I ftuar nga organizata ishte edhe presidenti i Fondacionit ZKM fr. Ruggero Valentini, i cili përfaqësoi Kopshtin e të Drejtëve të themeluar nga Fondacioni në vitin 2024 në Tiranë.

Po ju sjellim disa fragmente nga një përmbledhjeje e Benedetta Macripò drejtuese e Rrjetit Gariwo 2025, sipas të cilës takimet e Rrjetit Ndërkombëtar të mbajtura gjatë Gariwo Network përfaqësuan një moment kyç për rritjen e vazhdueshme të organizatës dhe shpresojmë edhe për të gjithë përfaqësuesit që u bashkuan nga gati dhjetë vende të botës.

Ky nuk ishte thjesht një takim koordinues, por një hapësirë dhe kontekst i krijuar qëllimisht për të nxjerrë në pah vlera të përbashkëta dhe ngjashmëri, diçka gjithnjë



e më e rrallë në botën e sotme. Rrjeti u rikonfirmua si një komunitet i ndërtuar mbi pluralizmin e kujtimeve, identiteteve, kulturave politike, luftërave dhe gjuhëve. Pluralizmi nuk është vetëm një shtyllë demokratike por edhe një vlerë që qëndron në zemër të çdo Kopshi të të Drejtëve.

Historitë lokale të rrënjosura në kontekste kulturore specifike bëhen universale sepse flasin gjuhën e dinjitetit njerëzor. Vëmendja ndaj rrjetit ndërkombëtar vazhdon rrugëtimin e nisur në qershor në Kombet e Bashkuara në New York me rastin e Ditës së Katërt Ndërkombëtare për kundërshtimin e gjuhës së urrejtjes.

Në këtë rast Gariwo pati nderin të zgjidhet nga Kombet e Bashkuara si një model i praktikës së mirë për të përfaqësuar një koalicion etik të aftë të kundërshtojë gjuhën e urrejtjes përmes kujtesës aktive qytetare dhe solidaritetit. Në këtë sfond të diplomacisë ndërkombëtare dhe angazhimit global takimi i nëntorit i mundësoi secilit përfaqësues të paraqiste arsyet historike, kulturore ose sociale që e bënë të domosdoshme krijimin e një Kopshti në vendin e tyre.

Pjesëmarrja tregoi sa të thella dhe të larmishme janë këto arsye që na bashkojnë.

Gjatë mëngjesit të së premtes më datë 28 çdo përfaqësues pati mundësinë të prezantohej dhe të ndante punën e tij duke ilustruar praktikën e suksesshme, vështirësitë e hasura dhe arsyet që qëndrojnë pas



Kopshit të tyre të të Drejtëve. Ishin të pranishëm përfaqësues nga Shqipëria ku Universiteti Katolik i Tiranës është në qendër të aktiviteteve edukative mbi të Drejtët, dhe pastaj nga **Neve Shalom Wahat al-Salam, Ruanda, Argjentina, Kurdistan i Irakut dhe Jordania, Varshava, Selaniku, Marseja** dhe vende të tjera këto kujtime gjenden në hapësirat publike duke i kthyer ato në mjete qytetare të edukimit demokratik dhe duke riinterpretuar vendet simbolike të kujtesës kolektive të shekullit të njëzetë nga pikëpamja e së Mirës.

Ka edhe shumë të tjerë përfshirë Kopshte që janë ende në fazë projekti si ai në San Marino dhe rrjete të shoqërisë civile si Platform of European Memory and Conscience dhe Fondacioni Edelstam që kontribuojnë përmes kërkimit shkencor, diplomacisë dhe njohurive të thelluara kulturore edhe në mungesë të një Kopshti



fizik. Ajo që i bashkon këto përvoja është bindja se demokracia mbijetoi aty ku njerëzit e zakonshëm zgjedhin guximin moral. Rrjeti ndërkombëtar nuk është një vitrinë, por një laborator ku takohen kujtesa, edukimi dhe imagjinata qytetare. Këto histori tregojnë fuqinë e pluralizmit jo si fragmentim, por si një vlerë demokratike dhe gjuhë morale universale.

Siç u theksua në seancën plenare rrjeti ndërkombëtar është pasqyra e Gariwo-s në botë, përmes të veçantës ai shpreh universalen. Kopshtet nuk janë vende vetëm për të përkujtuar tragjeditë, por vende shprese, të

rrënjësura në "metodën Gariwo": Mirënjohje ndaj atyre që zgjedhin të mirën sepse kërkimi i historive dhe besimi se e mira gjeneron mirëqenie të brendshme dhe jo sakrificë ia vlen. Ato tregojnë se bota mund të riparohet gjithmonë nga veprimi njerëzor madje edhe nga individë të brishtë. Për Gariwo-n ky takim ishte një



moment frymëzimi, njohjeje dhe lidhjeje. Në një epokë ku gjetja e një gjuhe të përbashkët është gjithnjë e më e vështirë ne donim të ofronim një hapësirë ku të dilnin qartë vlerat që na bashkojnë si përgjegjësia, empatia, dinjiteti njerëzor dhe guximi moral. Së bashku përmes këtij rrjeti qëllimi ynë është të shndërrojmë kujtesën në veprim qytetar dhe të ndërtojmë një aleancë morale të vërtetë globale për të ardhmen.

<https://it.gariwo.net/network/riflessioni-sulla-rete-internazionale-dei-giardini-dei-giusti-dopo-il-network2025-29298.html>

BIBLIOTEKA NË NJË VIT

Arritjet e sfidat që na presin



nga Mimoza Agastra

Përgjegjëse i Bibliotekës 'Fr. Paolo Ruatti'
në UKZKM

Biblioteka Universitare Fr. Paolo Ruatti, si çdo bibliotekë universitare në fund të vitit, sëbashku me heqjen e fletës së fundit të kalendarit, bën edhe bilancin e saj të sukseseve, arritjeve, risive dhe sfidave. Ajo ka mbyllur suksesshëm një vit me arritje domethënëse, duke u konfirmuar si një nga qendrat kryesore të dijes dhe kërkimit shkencor në

universitetet. Si një arritje kryesore e saj mund të përmendim faktin që ajo është pasuruar ndjeshëm me tituj të rinj të larmishëm në tematika e gjuhë, çka nuk është thjesht një arritje, por **një vlerë e shtuar** nga viti në vit i pasurisë së saj, e cila është në shërbim si të përdoruesve të brendshëm ashtu dhe atyre të jashtëm.

Falë kësaj larmishmërie dhe një fondi të azhurnuar ajo vjen e kërkuar edhe nga përdorues të jashtëm të cilëve nuk ua mbyll dyert e dijes, por kthehet në **një laborator të dijes**, duke iu përmbajtur misionit fillestar të saj. Një risi prej dy vitesh është edhe rritja pa limit e porosive për tekste shkencore në gjuhën angleze si tekste bazë në procesin akademik dhe alternativë për përgatitjen e tezave në përfundim të studimeve akademike. Krahas teksteve shkencore, fondi është rritur e pasuruar edhe me libra artistike, ardhur kjo si një kërkesë e vetë studentëve në kohën e lirë. Një tjetër hap i rëndësishëm dhe i suksesshëm ka qenë edhe rritja e abonimeve në data base të ndryshëm të



kërkimit shkencor, i cili u ka mundësuar studentëve dhe studiuesve akses më të shpejtë dhe më të gjerë, pavarësisht vendndodhjes së tyre. Ndërkohë, platforma e re online e bibliotekës ka regjistruar një rritje të ndjeshme të përdorimit, duke dëshmuar orientimin e qartë drejt shërbimeve moderne. Biblioteka vazhdimisht tenton të formësojë një koncept bashkëkohor në shërbimet e saj duke organizuar trajnime e leksione të hapura për zhvillimin e aftësive kërkimore, duke forcuar rolin e saj si një hapësirë e gjallë akademike dhe komunitare.

Në aspektin kulturor ajo vazhdon të promovojë e të inkurajojë talentët e rinj në fusha të ndryshme të artit e të shkencës, duke u krijuar atyre një terren tërësisht të tyre, një oaz kulture, në një ambjent shkencor. Një nismë e re e Bibliotekës në këtë vit është Antologjia e studentëve dhe e stafit për të gjithë ata që kanë pasionin krijimin në poezi apo në prozë, si një gjurmë e jetës akademike. Për herë të parë në historinë e universitetit kjo nismë ngazëllen talentet krijues e adhurues të letërsisë.

Biblioteka ndër vite ka demonstruar që nuk është thjesht qendër dije, por edhe hapësira sociale për komunitetin universitar. Ajo vazhdimisht ka influencuar përmes grupit të vullnetarëve që është shtyllë mbështetëse e saj për mbarëvajtjen e sallës së leximit të forcojë lidhjet sociale. Janë ata që bëjnë socializimin ndër breza dhe “mikpresin” brezat e rinj duke i ndërgjegjësuar për rregullat e funksionimin e bibliotekës. Një tjetër arritje e bibliotekës është edhe Dhurimi.

Ajo ka dhuruar prej fondit të saj mjaft libra në gjimnaze shtetërore duke promovuar edhe suksesin e rëndësishëm që ka leximi dhe biblioteka në tërësinë e saj përmes shembujve të studentëve tanë që kanë sjellë dëshminë e tyre të suksesit duke studiuar pranë universitetit tonë. **Një tjetër risi këtë vit nga biblioteka ka qenë edhe Nisma “ Dhuro Librat e fëmijërisë suaj”** ku mjaft studentë i janë bashkuar kësaj iniciative duke gëzuar shumë komunitete të shkolla të fshatrave për të cilën kanë ndjerë dhe prekur gëzimin që vetëm një libër i dhuruar me dashuri di të trasmetojë. Empatia e studentëve tanë është kartolina më e bukur e këtij fundviti. Humanizmi i studentëve frekuentues të bibliotekës spikat këtë vit me një tjetër aspekt, atë të dhurimit të një kontigjenti ndihmash për një komunitet fëmijësh të braktisur.

Janë ata vetë që mbështesin nismën e iniciuar nga stafi. Kjo është nisja e kësaj nisme për të vazhduar vitin e ardhshëm edhe me vizita familjare.

Për tu bërë pak caste “ Familja e tyre” Aktivitetet kulturore, prezantimet e librave, ekspozitat e punimet e ndryshme sjellin

studentët në një tjetër integritet. Pra, sfida jonë e ardhshme e vitit të ri jo vetëm akademik, por edhe kalendarik në një epokë ku teknologjia mund të izolojë individin të mund të ruajmë funksionin unik: të mbetemi ura sociale, ku bashkohet studimi, komunikimi dhe komuniteti. Kjo do të i jepte bibliotekës moderne një rol thelbësor jo vetëm në arsim, por në krijimin e një mjedisi universitar më gjithëpërfshirës dhe më të lidhur, siç aktualisht jemi. Megjithatë, pavarësisht sukseseve, institucioni i Bibliotekës përballet me një sërë sfidash për vitin e ardhshëm.

Në krye të tyre qëndron nevoja për zgjerimin e hapësirave fizike, për shkak të rritjes së vazhdueshme të numrit të përdoruesve. Një tjetër prioritet është përmirësimi i infrastrukturës teknologjike, veçanërisht kompjuterëve dhe pajisjeve për studime të avancuara, si dhe rritja e stafit mbështetës për të përballuar kërkesën në rritje. Përballë këtyre sfidave, Biblioteka Universitare mbetet e angazhuar të vazhdojë misionin e saj: të ofrojë mbështetje të pakushtëzuar ndaj procesit të mësimdhënies, kërkimit dhe inovacionit, duke qenë një nga shtyllat kryesore të jetës akademike.



TAKIMET E ARDHSHME



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

Premiazione

MIGLIOR TESI

17 Dicembre 2025

15:30

Casa Rossa

Università Cattolica
Nostra Signora del Buon Consiglio
Tirana



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO



ALUMNI REUNION

18 dicembre 2025

18:00

Aula Magna
Università Cattolica
"Nostra Signora del Buon Consiglio"
Tirana

*Save
the
date!*

GIARDINO
DEI GIUSTI



ZGJIDH TË
DREJTIN!
16 Janar
2026!



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO



CONFINDUSTRIA
ALBANIA

20 anni
2005-2025

FACOLTÀ DI FARMACIA



28 GENNAIO 2026 | ORE 10:00
AULA MAGNA

Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio"
Tirana

*Gëzuar Krishtlindjen!
Buon Natale!
Merry Christmas!*



**FONDAZIONE
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO**
Tirana

Dedicata all'educazione, dedicata alla salute

Me dashurinë e Zotit në zemër, me besim tek Lindja e Krishtit ju urojmë kohë të mbarë!

Con l'amore di Dio nel cuore e con fede nella Nascita di Cristo, vi auguriamo un tempo di pace e di bene!

With God's love in our hearts and faith in the Birth of Christ, we wish you a time of peace and goodness!

*Gëzuar
Buon
Happy*

2026



**Fondazione
Nostra Signora del Buon Consiglio**
Tirana

Dedicata all'educazione, dedicata alla salute